

BOJAKËT



FUGA PRO

Ngjyra	Paketimi
24 ngjyra	5KG

PËRSHKRIM

Fuga Pro është produkt me bazë çimento (C) me performance të lartë, jo irritues për mbushje fugash (G), me forcë ngjitëse të përmirësuar (2), absorbim i ulët i ujit (W) dhe rezistent ndaj abrazionit. Produkti është i përbërë nga rezina dhe lëndë të para inovative, silice kristaline, filler me bazë perliti dhe pigmente inorganike.

REKOMANDIME

Përdoret për ambiente të jashtme dhe të brendshme, për dysheme dhe mure, ngrohje qendrore, tarraca, ballkone, pishina, shatërvane. Fuga Pro përdoret për mbushjen e hapësirave nga 2 deri në 8 mm për pllaka qeramike, porcelani, pllaka mozaiku, pllaka guri, mermer, granit etj.

AVANTAZHET

- Krijon sipërfaqe kompakte, të lëmuar dhe të plotë.
- Punohet për një kohë të shkurtër dhe lahet lehtë
- Punueshmëri e shkëlqyer
- Nuk e transmeton ujin
- Rezistent ndaj mykut dhe baktereve
- Rezistent ndaj abrazionit
- Kundra eflorëshensës
- E qëndrueshme dhe ngjyra të njetrajtshme.

PËRGATITJA E MASËS

Aplikojmë Fuga Pro duke përdorur malle gome. Fugat mbushen duke bërë lëvizje diagonale të gominës dhe të hiqet produkti i tepërt nga pllaka. Kur produkti të ketë arritur kohën e duhur të tharjes (pas 15-30 minutave), bëhet pastrimi dhe përfundimi i sipërfaqes së fugave duke përdorur një sfungjer të lagur dhe shtrydhur mirë. Nëse pastrimi i fugës bëhet shumë shpejt kur produkti është ende i njomë ekziston mundësia që të humbasë ngjyrën pas ngurtësimit.

PËRGATITJA E PRODUKTIT

Përpara përdorimit, sigurojmë që sipërfaqja të jetë e pastër, e qëndrueshme, e thatë dhe e trajtuar, e niveluar dhe e rrafshët. Forca mekanike e suportit ku aplikohet produkti duhet të jetë e pranueshme. Duhet të kontrollojmë temperaturën e ambientit, lagështinë dhe kushte të tjera gjatë kohës së aplikimit. Sigurojmë që suportit ku aplikohet Fuga Pro (ngjitësi i pllakës, autoniveluesi, produktet e hidroizolimit) duhet të jenë të maturuara. Fugat duhet të jenë të pastra, pa pluhura dhe të kenë thellësinë e duhur për mbushje. Nëse mbushim fuga në pllaka që absorbojnë shumë dhe në prezencë të kushteve atmosferike të ngrohta, duhet të përdorim sfungjer të lagur me ujë.







PËRGATITJA E MASËS

Në një enë të pastër hedhim 30-32% ujë dhe përziejme me përzierës elektrik me xhiro të ngadalta Fuga Pro deri sa të krijohet një masë e njëtrajtshme në formë paste. E lëmë në qetësi për 2-3 min dhe e përziejme përsëri. Produkti i përgatitur përdoret për 25-35 minuta.

PLLAKA		KONSUMI NË VARËSI TË GJERËSISË SË FUGAVE			
		2 mm	4 mm	6 mm	8 mm
2 x 2	kg/m ²	1.00			
5 x 5	kg/m ²	0.85	1.75		
10 x 10	kg/m ²	0.40	0.85	1.30	2.20
7.5 x 15	kg/m ²	0.40	0.85	1.30	2.20
12 x 24	kg/m ²	0.25	0.70	1.05	1.75
15 x 15	kg/m ²	0.25	0.55	0.85	1.45
20 x 20	kg/m ²	0.25	0.55	0.85	1.40
20 x 30	kg/m ²	0.20	0.45	0.70	1.15
30 x 30	kg/m ²	0.15	0.35	0.55	0.95
40 x 40	kg/m ²	0.10	0.25	0.40	0.70
50 x 50	kg/m ²	0.10	0.20	0.35	0.60
60 x 60	kg/m ²	0.05	0.15	0.25	0.45

TË DHËNAT TEKNIKE

Ngjyra: I disponueshëm në 24 ngjyra	Pastrimi i fugave: Pas 20 minutash
Stukimi në dyshe: 24 orë	I shkëlshëm: Pas 24 orësh
Ruajtja: Ruhët në paleta	Forca në shtypje në 28 ditë: ≥30 N/mm ²
Koha e magazinimit: 12 muaj nga data e prodhimit	Forca në shtypje pas cikleve ngrirje-shkrirje: ≥21.2 N/mm ²
Densiteti: 1.2 gr/cm ³	Tkurrja: 2.91 N/mm ²
Sasia e ujit: 1.5-1.7 litër ujë për 5 kg	Fleksibiliteti (28 ditë): ≥ 6.8 N/mm ²
pH: 13	Absorbimi i ujit pas 30 minutash: ≤ 2 g
Temperatura e aplikimit: +5°C deri në +35°C	Absorbimi i ujit pas 240 minutash: ≤ 5g
Koha e punueshmërisë: 25-35 min	Fleksibiliteti pas cikleve ngrirje-shkrirje: ≥ 5.2N/mm ²



Kujdes! Për suporte ku është kaluar hidroizoluesi dhe formate të mëdha pllakash vendosja e fugës bëhet 4-5 ditë pas aplikimit të kollës, në fund të bashkimit me murin aplikohet silikon me të njëjtën ngjyrë me fugën.